



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

KUVENDI

Komisioni për Integrimin Europian

PROCESVERBAL

Tiranë, më 14.05.2018, ora 11:00

Drejtton mbledhjen:

Bledar Çuçi – nënkryetar i Komisionit

Rendi i ditës:

1. Miratimi i procesverbaleve të datave 11. 04. 2018, 16. 04. 2018 dhe 25. 04. 2018.
2. Shqyrtimi i projektligjit “Për trashëgiminë kulturore dhe muzetë”.
3. Të tjera.

Marrin pjesë:

Bledar Çuçi, Fatmir Velaj, Elisa Spiropali, Musa Ulqini, Ilir Pendavinji, Arben Kamami, Klodiana Spahiu, Sadri Abazi, Taulant Balla dhe Viktor Tushaj.

Mungojnë:

Genc Pollo, Aldo Bumçi, Grida Duma, Jorida Tabaku, Vangjel Dule, Viktor Tushaj, Klajda Gjasha.

Të ftuar:

Valbona Shujaku – Zëvendësministre e Kulturës

Edmond Ahmeti – Drejtor i Drejtorisë së Koncesioneve, Prokurimeve dhe Partneriteteve

Arlinda Kondi - përgjegjës sektori në sektorin e politikave dhe strategjive të kulturës, Drejtoria e Politikave dhe Strategjive të Zhvillimit Kulturor.

HAPET MBLEDHJA

Bledar Çuçi – Mirëdita të gjithëve!

Kuorumi është plotësuar, kështu që fillojmë mbledhjen e Komisionit për Integrimin European për ditën e sotme.

Në rendin e ditës së mbledhjes së sotme kemi miratimin e procesverbaleve të datave 11.04. 2018, 16.04. 2018, 25.04.2018, si dhe shqyrtimin e projektligjit “Për trashëgiminë kulturore dhe muzetë”. Ne jemi komision për dhënie mendimi.

Çështja e fundit e rendit të ditës ka të bëjë me diskutime të tjera.

Jeni dakord me rendin e ditës?

Pro? Kundër? Abstenim?

Miratohet.

Fillojmë me pikën e parë të rendit të ditës, miratimin e procesverbalit të datës 11. 04. 2018.

Pro? Kundër? Abstenim?

Miratohet.

Vazhdojmë me miratimin e procesverbalit të datës 16. 04. 2018.

Pro? Kundër? Abstenim?

Miratohet.

Hedhim në votim procesverbalin e datës 25. 04. 2018.

Pro? Kundër? Abstenim? Nuk ka.

Miratohet.

Vazhdojmë me pikën tjetër, shqyrtimin e projektligjit “Për trashëgiminë kulturore dhe muzetë”.

Kemi të ftuar nga Ministria e Kulturës zonjën Valbona Shujaku, zëvendësministre e Kulturës, zotin Edmond Ahmeti, drejtor i Drejtorisë së Koncesioneve, Prokurimeve dhe Partneriteteve, si dhe zonjën Arlinda Kondi, përgjegjëse sektori në sektorin e politikave dhe strategjive të kulturës në Drejtorinë e Politikave dhe Strategjisë së Zhvillimit Kulturor.

Mirë se keni ardhur!

Relator i këtij projektligji është zoti Fatmir Velaj.

Fillimisht dëgjojmë prezantimin e projektligjit nga përfaqësuesit e Ministrisë së Kulturës dhe pastaj procedojmë me pyetje dhe diskutime.

Fjala është për ju. Ju lutem jini sa më koncizë, sepse ne jemi fokusuar më shumë te çështjet e përafrimit të legjislacionit me direktivat e Bashkimit European.

Valbona Shujaku – Ky projektligj është përgatitur nga Ministria e Kulturës, konkretisht Drejtoria Juridike e Marrëveshjeve, Drejtoria e Integritit dhe Përafrimit të Legjislacioneve dhe Drejtoria e Trashëgimisë Kulturore dhe Muzeve.

Projektligji është parashikuar edhe në planin kombëtar për integrimin european 2017-2020, miratuar me vendim nr. 42, datë 25. 01. 2017 të Këshillit të Ministrave.

Projektligji “Për trashëgiminë kulturore dhe muzetë”, synon të përafrojë legjislacionin shqiptar me *acquis* të Bashkimit European, në fushën e kulturës, konkretisht Direktivën e Këshillit të Europës dhe Parlamentit European të datës 15 maj 2014, 2014/60/EU, “Mbi kthimin e objekteve kulturore të hequr në mënyrë të paligjshme nga territori i një shteti anëtar dhe amendon rregulloren (EU) nr.1024/2012”, si dhe Rregulloren e Këshillit të Europës nr.116/2009, datë 18 dhjetor 2008, “Për eksportin e pasurive kulturore”.

Kemi rakorduar paraprakisht me komisionin që të reflektojmë korrigjimin e disa gabimeve teknike dhe gjuhësore”.

Bledar Çuçi – Faleminderit!

Unë kam informacion që keni rakorduar me ekspertin e Kuvendit për disa propozime tonat për çështjen e përafrimit. Kështu që, besoj se paraqitja që sapo bëtë pasqyron sugjerimet që ne kemi bërë.

Fjalën e ka relatori.

Fatmir Velaj – Së pari, ju falenderoj që më keni zgjedhur mua relator të këtij projektligji, kjo ndoshta sepse i përkas fushës së artit, kulturës dhe trashëgimisë kulturore.

Sipas asaj që kam lexuar dhe studiuar gjatë kësaj kohe për përafrimin e ligjit të trashëgimisë kulturore, duke u bazuar në përvojat dhe eksperiencat më të mira të Bashkimit European, kam krijuar bindjen që është bërë një punë jo thjesht e madhe në kohë, por një punë e madhe studimore. Vërejtjet apo sugjerimet e bëra nga njësia e përafrimit janë marrë parasysh, kështu që mendoj se ky projektligj duhet të votohet pasi përshtatet më së miri me atë të Bashkimit European.

Meqë kemi prezente ish-ministren e Integritit European, të nderuarën zonjën Klajda Gjoshë, dua t’ju kujtoj një shprehje të madhe, që Zhan Mone ka lënë para se të vdiste në vitin ‘73: “Nëse do të më jepej edhe një herë mundësia për të bashkuar Europën, do ta nisja nga kultura”.

Ne, si vend aspirues i Bashkimit European, me ligjin “Për trashëgiminë kulturore” bëhemi ende disa hapa pranë Europës dhe jam i bindur se ky është një dokument dinjitoz, që do ta afrojë më shumë Shqipërinë drejt Europës. Këtë doja të thosha.

Bledar Çuçi – Faleminderit!

Shkurtimisht fjala është për zotin Kasneci, për të na dhënë opinionin ose ekspertizën për këtë çështje.

Dedë Kasneci – Faleminderit, zoti kryetar!

Projektligji “Për trashëgiminë kulturore dhe muzetë” përafrohet me dy akte ligjore të BE-së, konkretisht direktivën 2014/60 të BE-së, të Parlamentit European dhe të Këshillit të datës 15 maj 2014 “Për kthimin e objekteve kulturore të nxjerra në mënyrë të paligjshme nga territori i një shteti anëtar”, si dhe me Rregulloren e Këshillit, nr. 116/2009 të datës 18 dhjetor 2008 “Për eksportin e mallrave kulturore”.

Nga shqyrtimi i përputhshmërisë që shërbimi ynë i ka bërë projektligjit, kemi arritur në përfundimin se për një afrim më korrekt të projektligjit me dispozitat e legjislacionit përkatës të BE-së, është e nevojshme që në tekstin e tij të bëheshin disa korrigjime, disa saktësime. Në total janë 5. Këto i kemi diskutuar edhe me ekspertët e qeverisë dhe është dhënë dakordësia për përfshirjen e tyre në materialin që do të dërgohet.

Faleminderit!

Bledar Çuçi– Faleminderit, zoti Kasneci!

Ka pyetje për relatorin?

Ka diskutime? Nuk ka.

Kalojmë në miratimin e projektligjit.

Siç kemi bërë edhe herë të tjera nga praktika për projektligjet që nuk jemi komision përgjegjës, por komision për dhënie mendimi, ne e kemi përgatitur relacionin edhe sipas vërejtjeve të bëra nga eksperti i Kuvendit dhe relatori. Relacioni reflekton edhe sugjerimet e bëra, që sapo i tha edhe relatori, edhe eksperti i Kuvendit, siç kanë rënë dakord edhe me përfaqësuesit e ministrisë, ndaj mendoj ta hedhim në votë këtë relacion.

Votojmë relacionin ku përmbahen ndryshimet apo propozimet për komisionin përgjegjës, që kanë të bëjnë me:

Pika e parë: Shënim në fund të faqes, që lidhet me titullin e projektligjit dhe formulohet si vijon. Pra, shënimin që ne kemi pasur gjithmonë si vërejtje të përgjithshme gjatë gjithë kohës për çështjet që kanë të bëjnë me përafrimin e legjislacionit.

Pikë e dytë: Në pikën 25 të nenit 5 të projektligjit, që jep përkufizimin e termit “koleksione publike” me riformulimin si më poshtë: “Ato koleksione që janë të aksesueshme

nga publiku, pavarësisht të drejtave të pronësisë së mbajtësit, ku përfshihen objekte me interes artistik, dokumentar, historik dhe shkencor”.

Si pikë e tretë, propozimi për ndryshimin e pikës 31 të nenit 5 të projektligjit, ku jepet përkufizimi i termit “licencë eksporti” me formulimin si më poshtë:

“Licencë eksporti, dokumenti zyrtar i lëshuar nga autoriteti kompetent shtetëror, që autorizon eksportin e pasurive kulturore jashtë territorit doganor të Republikës së Shqipërisë”.

Pikë e katërt: propozim për ndryshimin e pikës 72 të nenit 5, sërish të përkufizimet, që të hiqet termi “kthim”.

Pika e pestë: titulli i nenit 122, si dhe pikat 1 dhe 2/a të këtij ligji me riformulimet e mëposhtme:

Neni 122, “Parimet në lidhje me nxjerrjen e paligjshme të pasurive kulturore të luajtshme jashtë territorit të Republikës së Shqipërisë”.

Pika 1 riformulohet si më poshtë:

“Pasuritë kulturore të luajtshme, të cilat janë nxjerrë nga territori i Republikës së Shqipërisë në mënyrë të paligjshme, në kuptimin e pikave 2 dhe 3 të këtij neni, kthehen në territorin e Republikës së Shqipërisë, sipas parashikimeve të këtij ligji dhe marrëveshjeve ndërkombëtare”.

Pika 2 propozohet të ndryshohet si më poshtë:

“Konsiderohet e paligjshme dalja nga territori i Republikës së Shqipërisë të vlerave kulturore të parashikuara në këtë ligj në këto raste:

a. kur nxirret nga territori i Republikës së Shqipërisë në shkelje të rregullave për mbrojtjen e pasurive kulturore të luajtshme të përcaktuara në këtë ligj.

Këto janë edhe amendimet që kemi propozuar, që janë pasqyruar edhe në relacionin përkatës të hartuar nga komisioni.

Kalojmë në votim.

Kush është dakord me relacionin për t’ia dërguar komisionit përgjegjës, me vërejtjet përkatëse që unë sapo lexova? Kundër? Abstenim? Nuk ka.

Miratohet.

Relacioni që sapo miratuam do t’i dërgohet komisionit përgjegjës si rekomandime nga Komisioni për Integrimin Europian.

Gjithashtu, edhe ministrisë përgjegjëse do t’i dërgojmë edhe korrigjimin e tabelave të përputhshmërisë që shoqërojnë ligjin, edhe sipas vërejtjeve që bëri eksperti.

Faleminderit!

Pika 5. Ka diçka për të shtuar? Nuk ka.

Faleminderit!

Mbyllet mbledhja e sotme e Komisionit të Integritetit.

Mbledhja e ardhshme do të lajmërohet nëpërmjet postës elektronike.

Faleminderit!

MBYLLET MBLEDHJA

